

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	42 minutat fatale të Giorgos Mazonakis, çfarë ndodhi në klinikë para vdekjes
ADRESA	https://piranjat.al/bota/42-minutat-fatale-te-giorgos-mazonakis-cfare-ndodhi-ne-klinike-para-s-i106448
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:42:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9759d0717d45e11e7e4b581643f57ef431eb1af5bb27bc971321cece6a6a3e41
TEKSTI	c0266b99064f58a3eaa89f5dc5ff0ad7c90faa9ea6d35729f87a8b0ad13127b1
PAMJA	974a311b728032728fcb03421b5b68584347cdf180a5e5de4af64e76c0b87bae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	165c2869565ddcad2f88bf14bd47d03f18d2b51cf6ca2e32ee0427441f13d5df
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/165c2869565ddcad2f88bf14bd47d03f18d2b51cf6ca2e32ee0427441f13d5df>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [shpërthimit në Athinë](#) ■ [Plaka bisi nga apartamenti i katit](#) ■ [së përbashkët](#) ■ [partie politike kosovare në](#) ■ [Iraklië. Të gjitha trupat ameri](#) ■ [shantazhi politik në](#) ■ [reaguar Partia Demokratike. Shtes](#) ■ [Vudi Xhymshiti](#) ■ [faqet e tij në rrjetet sociale](#) ■ [e d](#)

[BOTA](#)

42 minutat fatale të Giorgos Mazonakis, çfarë ndodhi në klinikë para vdekjes

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 18:27



Autoritetet hetimore greke priten të marrin në ditët e ardhshme të dhëna që mund të jenë vendimtare për hetimin e vdekjes së këngëtarit Giorgos Mazonakis. Sipas "Proto Thema", rezultatet e analizave toksikologjike dhe histologjike priten brenda javës dhe mund t'i japin përgjigje pyetjes kryesore që u ngrit pas konstatimit të vdekjes së 54-vjeçarit, pasditen e 9 shtatorit: cili ishte shkak i vdekjes?

Autopsia, e kryer dy ditë pas vdekjes në praninë e ekspertit teknik të familjes dhe të një eksperti të dy mjekëve që ndodhen në paraburgim, nuk përcaktoi shkakun e vdekjes. Megjithatë, të dhënat që kanë dalë gjatë hetimit kanë ngritur disa hipoteza për mekanizmin që mund të ketë çuar në vdekje.

Ndërkohë, autoritetet po analizojnë të dhënat e siguruar pas heqjes së sekretit të komunikimeve telefonike. Drejtoria e Hetimeve Kriminalistike e Policisë po i dorëzon hetuesit materiale të reja, ndërsa po shqyrtohet edhe përfshirja e personave të tjerë. Sipas medias greke, hetimi mund të zgjerohet ndaj personave të tjerë dhe mund të ndryshojë edhe akuza ndaj dy mjekëve që ndodhen aktualisht në paraburgim.

Një nga punonjëset e klinikës në rrugën Karneadou ka dëshmuar para hetuesit për atë që ndodhi ditën e vdekjes së këngëtarit.

Sipas dëshmisë së saj, Mazonakis kishte marrë medikamente për sedacion. Punonjësjë deklaroi se mjekja Ioanna Gaka i kërkoj antidotin kur konstatoi se gjendja e këngëtarit po përkeqësohej.

Ajo dëshmoi gjithashtu se klinika kishte një defibrilator, por pajisja nuk funksionoi sepse nuk ishte e karikuar.

Sipas një tjetër dëshmie të cituar në material, përveç anesteziologes me të cilën u komunikua në momentet kritike, personeli telefonoi edhe furnizuesin e defibrilatorit për të pyetur pse pajisja nuk funksiononte. Përgjigjja, sipas dëshmisë, ishte se pajisja duhej të ishte karikuar.

Në të njëjtën kohë, sipas dëshmisë së punonjëses, në një dhomë tjetër të klinikës një grua po i nënshtrohej plazmaferezës.

Dëshmia e punonjëses 53-vjeçare merr rëndësi edhe për një tjetër element të hetimit. Ajo deklaroi se Gaka u kërkoj personave që ndodheshin në klinikë të mbanin një "qëndrim të përbashkët" për atë që kishte ndodhur më 9 shtator. Sipas "Proto Thema", këtë pretendim e konfirmoi në dëshminë e saj edhe një punonjëse e dytë.

Megjithatë, avokati i familjes Mazonakis, Charalambos Lykoudis, pretendon se pjesë të kësaj dëshmie i shërbejnë linjës së mbrojtjes së mjekut Ilias Theodoropoulos, i cili ndodhet në paraburgim.

Sipas dëshmisë, "mjeku po flinte në divan". Materiali i medias greke vë në pikëpyetje këtë version, duke iu referuar komunikimeve që u kryen gjatë përkeqësimit të gjendjes së këngëtarit dhe veprimeve të tjera që pretendohet se janë kryer në klinikë.

Lykoudis tha se analizat toksikologjike priten të tregojnë sedativët dhe barnat e administruara. Sipas tij, të dhënat e komunikimeve telefonike mund të dokumentojnë gjithashtu kontaktet me anesteziologun dhe telefonatat e tjera të kryera atë ditë.

Hidroterapia dhe plazmafereza

Hetimi është përqendruar edhe te procedurat që iu kryen këngëtarit brenda një periudhe më të shkurtër se 24 orë.

Sipas materialit, një fotografi e Mazonakis në klinikën e Theodoropoulos dhe Gaka e rikuperuar gjatë hetimit solli në vëmendje hipnoterapistin Nasos Komianos.

Hetuesit po shqyrtojnë marrëdhënien mes tyre dhe arsyen pse fotografia iu dërgua Komianos.

Sipas "Proto Thema", Mazonakis iu nënshtroa fillimisht hidroterapisë së zorrës më 8 shtator dhe më pas plazmaferezës. Procedura e dytë nuk përfundoi.

Të dhënat e regjistruara nga pajisja, sipas medias, tregojnë se këngëtari vdiq 42 minuta pas nisjes së procedurës.

Dy mjekët e paraburgosur kanë paraqitur një version tjetër. Sipas pretendimit të tyre fillestar, Mazonakis u rrezua përpara se të fillonte plazmafereza.

Një tjetër çështje që po shqyrtohet është intervali i shkurtër mes hidroterapisë së zorrës dhe plazmaferezës.

Anestezilogu i Spitalit Attikon, Dimitris Manikis, ka deklaruar se hidroterapia mund të shkaktojë dehidratim, ndërsa plazmafereza kërkon që pacienti të jetë i hidratuar në mënyrë të përshtatshme.

Mjeku ligjor Grigoris Leon tha për “Proto Thema” se përveç dehidratimit duhet marrë parasysh edhe çrregullimi i elektroliteve, përfshirë kaliumin dhe natriumin, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në funksionimin e zemrës.

Megjithatë, shkaku përfundimtar i vdekjes nuk është përcaktuar. Përgjigjet priten nga analizat toksikologjike dhe histologjike.

Leon vlerësoi se rezultatet e këtyre analizave, të shqyrtuara së bashku me veprimet dhe mosveprimet gjatë momenteve kritike, mund të tregojnë se mekanizmi i vdekjes lidhej me një kombinim faktorësh.

Pyetjet që mbeten pa përgjigje

Mjeku ligjor Grigoris Leon ka ngritur disa çështje që, sipas tij, duhet të sqarohen gjatë hetimit.

Një prej tyre lidhet me gjendjen e Mazonakis kur mbërriti në klinikë. Sipas dëshmisë fillestare të mjekes, këngëtari kishte mbërritur “në gjendje të keqe”. Leon pyet pse, në këto rrethana, nuk u kërkuar analiza gjaku, ekzaminime kardiologjike apo të paktën një elektrokardiogram.

Një tjetër çështje lidhet me barnat e anestezisë që pretendohet se iu administruan këngëtarit dhe mënyrën se si këto medikamente ndodheshin në klinikë.

Hetuesit po përpiqen të përcaktojnë gjithashtu dozën dhe llojin e barnave të administruara.

Në material përmenden tri substanca: propofoli, midazolami dhe flumazenili, ky i fundit përdoret si antagonist i benzodiazepinave si midazolami. Sipas burimit, analizat toksikologjike pritet të tregojnë nëse dhe në çfarë kombinimi janë administruar këto substanca.

Një tjetër pikë që kërkon sqarim është se çfarë komplikacionesh shfaqti Mazonakis para kolapsit: nëse pati ulje të pulsit, aritmi, probleme me frymëmarrjen apo hipotension dhe si reagoi personeli ndaj tyre.

Sipas materialit të “Proto Thema”, hetimi po shqyrton gjithashtu pretendimin se dy mjekët kërkuar udhëzime përmes inteligjencës artificiale, ndërsa nuk telefonuan shërbimin grek të urgjencës, EKAB.

Leon tha se personeli i EKAB-it mund të japë udhëzime bazë përmes telefonit deri në mbërritjen e ekipit të urgjencës. Ai ngriti gjithashtu çështjen se përse pacienti nuk u shoqërua në spital nga mjekët e klinikës.

Hetuesit po analizojnë edhe komunikimet mes personave të përfshirë.

Sipas materialit, kur Gaka e informoi hipnoterapistin Nasos Komianos se këngëtari nuk dëshironte të kthehej në klinikë për plazmaferezën pas hidroterapisë, Komianos dysohet se iu përgjigj me një frazë që mund të përkthehet: “Do të merrem unë me të”.

Kuptimi i saktë i kësaj bisede pritet të vlerësohet në kontekstin e plotë të komunikimeve që janë përfshirë në dosjen hetimore.

Dëshmia e Komianos

Komianos dëshmoi para hetuesit dhe deklaroi se kontakti i parë lidhur me Giorgos Mazonakis kishte ardhur më 27 gusht, përmes një personi nga rrethi profesional i këngëtarit.

Sipas dëshmisë së tij, fillimisht nuk dëshironte ta merrte përsipër rastin për shkak të një shtrimi të mëparshëm të këngëtarit në spitalin Dromokaiteio.

Pas komunikimeve të mëtejshme, ai u takua me Mazonakis në një restorant në Psychiko më 7 shtator. Po atë ditë u zhvillua komunikimi me Gaka dhe u caktua hidroterapia për ditën pasardhëse.

Komianos u pyet edhe për një mesazh që i kishte dërguar Gakës, në të cilin, sipas materialit, shkruante: “Lëre, do ta fus unë”. Ai pretendoi se me këtë shprehje kishte parasysh se do ta përfshinte këngëtarin në programin e tij të takimeve.

Hetuesit ende nuk kanë sqaruar pse Gaka e fotografoi Mazonakis dhe pse ia dërgoi fotografinë Komianos.

Sipas “Proto Thema”, mbeten gjithashtu për t’u sqaruar plotësisht veprimet e Ilias Theodoropoulos. Ai ka paraqitur pretendimet e tij mbrojtëse, ndërsa prokurori dhe hetuesi vendosën ndaj tij të njëjtën masë paraburgimi si ndaj bashkëshortes së tij.

Theodoropoulos pritet të kërkojë heqjen e paraburgimit, duke propozuar si alternativë edhe arrestin shtëpiak.

Hetimi vazhdon, ndërsa rezultatet toksikologjike dhe histologjike pritet të jenë vendimtare për përcaktimin e shkakut të vdekjes dhe për vlerësimin e përgjegjësisë të mundshme penale.

Artikuj te sugjeruar

BOTA 28 Shtator18:16

[Ndizet konflikti Greqi-Turqi, ndërsa Europa vështro](#)

Është një përshkallëzim i vazhdueshëm akuzash nga të dyja palët: Greqia ankohet për shkelje të hapësir&eu...

BOTA 28 Shtator17:59

[Politikani i lartë rrihet për vdekje pasi kërkoi masa parandaluese për Ebolën, disa persona iu futën në banesë dhe e dhunuan brutalisht](#)

Një zyrtar i lartë i partisë qeverisëse në Republikën Demokratike të Kongos është rrahur për vdekje pasi mori ...

BOTA 28 Shtator17:02

[U dorëhoq si president, Vuçiç e lë porosi: Mos hiqni dorë nga Kosova](#)

Ndërsa mbajti fjalimin e dorëheqjes nga posti i presidentit, Aleksandër Vuçiç e vendosi Kosovën mes çështjeve me t...

BOTA 28 Shtator16:54

[“Mund të rrëzojmë çdo qeveri që duam”/ Deklarata e ambasadores amerikane shkakton polemika në Athinë, opozita kërkon shpjegime](#)

Partitë opozitare të Greqisë i kanë kërkuar qeverisë t’i përgjigjet një raporti të Wall Street Journal, sipas...

BOTA 28 Shtator16:29

[Vdekja e George Mazonakis, infermierja “gozhdon” dy mjekët e arrestuar: Të gjithë jemi përgjegjës](#)

Zhvillime të reja janë shënuar në hetimin për vdekjen e këngëtarit George Mazonakis, pasi një tjetër punonjëse...

BOTA 28 Shtator16:01

[Përfshihet nga flakët Akademia e Shkencave në Kiev pas sulmeve ruse, raportohet një viktimë dhe disa të plagosur](#)

Një grua humbi jetën dhe tre persona të tjerë u plagosën pasi një dron rus goditi të hënën një ndërtesë&eu...

BOTA 28 Shtator14:51

[Trupat amerikane përfundojnë tërheqjen nga Iraku](#)

Ushtria amerikane është tërhequr plotësisht nga Iraku, sipas një zyrtari të qeverisë irakiane. Të gjitha trupat ameri...

BOTA 28 Shtator14:00

[Akuzat për vjedhje/ Parlamenti hungarez i heq imunitetin kryeministrit Magyar](#)

Parlamenti në Budapest të hënën, i hoqi imunitetin parlamentar Magyarit me shumicë votash. Ky i fundit kishte kërkuar heqjen e ...

BOTA 28 Shtator12:18

[Pas dorëheqjes së Vuçiçit, Ana Brnabić caktohet Presidente në detyrë e Serbisë](#)

Ish-kryetarja e Parlamentit serb, Ana Brnabić, ka marrë zyrtarisht detyrën e Presidentes në detyrë të Republikës së Se...

BOTA 28 Shtator11:32

[“Jam drejtori”/ Zëri i rremë i AI mashtroi Intesa Sanpaolo-n, 95 milionë euro në duart e mashtruesve](#)

Banka Intesa San Paolo ka përjetuar një dështim të turpshëm të sigurisë, teksa një mashtrues ka arritur t'i vjed...

ME TE VIZITUARAT

LIFESTYLE 28 Shtator

[Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që ...](#)

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mirë&e...

AKTUALITET 27 Shtator

[Lulëzimi i çiftit Ergys dhe Dorina Verdho/ Nga ...](#)

Çifti Ergys dhe Dorina Verdho duhet të merret si “shembull” nga familjet shqiptare për mënyrën sesi kanë shumëf...

BOTA 27 Shtator

[Shpërthim gjatë fluturimit të avionit me pasagj...](#)


Një avion i Lufthansa-s, që po fluturonte nga Frankfurti drejt Lisbonës, u devijua të shtunën në mbrëmje, më 26 shtator,...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.